



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:123986

Datë: 21.08.2024

Numri i dokumentit: 06071499

P.nr.107/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICE, DEGA NË VUSHTRI-Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Arta Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit A.A., nga fshati ... komuna e Vushtrisë, te cilin sipas autorizimit e mbron av. Abit Asllani, për shkak te veprës penale Lëndim i rende trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.2 te KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit i Përgjithshëm PP-II-nr.712/2024 të datës 07.05.2024, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor të datës 22.07.2024 po te njëjtën dite mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 21.08.2024 përpiloi këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

A.A. nga i ati N... dhe nëna B..., e vajzërisë H..., i lindur më ..., në fshatin ..., Komuna Vushtrri, me vendbanim në rrugën "...", nr..., fshati ..., Komuna Vushtrri, beqar, i punsuar tek "...” - llamarinë punues, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

SEPSE:

Me datë 26.04.2024, rreth orës 19:40, në fshatin ..., Komuna Vushtrri, saktësisht afër xhamisë së fshatit, i pandehuri me dashje i shkakton lëndime trupore të dëmtuarit V.Z., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje që kishte ndodhur brenda në xhami, ku i pandehuri i kishte kërkuar hoxhës që i dëmtuarit të mos e thërras ezanin dhe për këtë i dëmtuari i kishte thënë “nëse nuk do mund të dalësh jashtë”, ashtu që i pandehuri del nga xhamia dhe e pret të dëmtuarit derisa mbaron namazi i akshamit dhe me të dal i dëmtuari nga rrethoja e xhamisë, i pandehuri e godet me shkop të drurit të gjatë rreth dy metra disa herë në krah të djathtë dhe pas koke, ku nga këto veprime të dëmtuarit i humb vetëdija rrëzohet në tokë, ashtu që i pandehuri vazhdon ta godas me grushte në fytyrë, me të cilat veprime të dëmtuarit i shkakton lëndime të rënda trupore, të cilat paraqesin: plagë të indeve të buta të kokës dhe qafës, gjakmbledhje nënlëkurore dhe ënjtje të indeve të buta të regjionit të hundës, grumbullim gjaku në hapësirat e nofullës së sipërme të anës së majtë të fytyrës, nxjerrje nga vendi i vet i nyjës (kyçit, artikulacionit) të supit të krahut të dorës së djathtë,

thyerje e kockës së hundës, thyerje e kockës (metakarpale) të gishtit të 4-të dhe 5-të (gishtit të unazës dhe gishtit të vogël) të shuplakës së dorës së djathtë.

- me këtë ka kryer veprën penale Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.2 të Kodit Nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës

Andaj gjykata duke u bazuar ne dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42 si dhe nenin 186 par.3 nwn par. 3.1 lidhur me par. 1 te KPRK-se si dhe neni 364, 452 dhe nenit 462 te KPPK-së Gjykata i shqipton:

DËNIM ME BURG

Me të cilin të akuzuarit A.A. i CAKTOHET dënimi me burg ne kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, i cili dënim do te ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga dt. nga data 26.04.2024 e deri me datë 22.07.2024, do ti llogaritet ne dënimin shqiptuar.

OBLIGOHET i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30€, ne emër te kompensimit te viktimave te krimit shumen prej 20€, ne emër te ekspertizës mjeko ligjore shumen prej 20€ si dhe ne emër te shpenzimeve te transportit shumen prej 60€.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP-II-nr.712/2024 të datës 07.05.2024, kundër të pandehurit A.A. nga fshati ... Komuna e Vushtrrisë, për shkak të veprës penale, Lëndimi i rëndë trupor nga neni 186 par. 3 nën par. 3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.2 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me datë 21.05.2024 ku në këtë seancë të shqyrtimit fillestar gjyqtari i vetëm gjykues e ka njoftuar te pandehurin me të drejtat e tij në këtë çështje penale. Te pandehurit i është lexuar aktakuza PP-II-nr.712/2024 të datës 07.05.2024 nga ana e prokurorit te shtetit dhe i njëjti është deklaruar se e kupton ne tërësi aktakuzën.

Lidhur me pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, i pandehuri ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Mitrovice.

Duke qene se i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë sipas aktakuzës, gjykata ne vështrim te dispozitave te nenit 243 te KPP-se te njëjtit i ka dhënë mundësinë e kundërshtimit te aktakuzës, por qe i pandehuri as mbrojtësi i tije nuk kane paraqitur kundërshtim te aktakuzës.

Pasi qe janë krijuar kushtet ligjore, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor te dt. 22.07.2024, ne te cilin shqyrtim prezent ka qenw prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tije sipas autorizimit, si dhe i dëmtuari dhe përfaqësuesi i te dëmtuarit. Ne seancën e shqyrtimit gjyqësor i pandehuri është njoftuar me te drejtat e tija ne kuptim te dispozitave te nenit 319 te KPP-së, dhe te njëjtit i është lexuar aktakuza. Ne kuptim te dispozitave te nenit 321 te KPP-së, pasi qe gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, të akuzuarit i është dhënë mundësia të pranojë ose të mos e pranoj fajësinë sipas aktakuzës.

I pandehuri pas konsultimeve te mjaftueshme me mbrojtësin e tij ka deklaruar se don ta pranoj fajësinë sipas aktakuzës dhe ka shtuar i kërkon falje të dëmtuarit dhe gjykatës për rastin që ka ndodh.

Pas pranimit të fajësisë, gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të pandehurit lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë dhe të njëjtin e ka njoftuar për dënimet e parapara, se nuk do të mund të kundërshtojë provat apo të parashtoj prova në këtë çështje penale, se nuk mund ta atakojë vendimin e gjykatës për shkak të vërtetimit jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por mund ta atakojë për shkak të lartësisë së dënimit dhe se deklarimi mbi pranimin e fajësisë, gjykata detyrimisht do ta vlerësojë si rrethanë lehtësuese, gjykata paraprakisht e ka njoftuar te pandehurin rreth benefiteve lidhur me pranimin e fajësisë.

I pandehuri në shqyrtimin gjyqësor edhe pas tërheqjes së vërejtjes lidhur me pasojat e pranimit të fajësisë, i njëjti ka deklaruar se e ndien vetën fajtor.

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se deklarimi mbi pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është në përputhje me dispozitat e KPPRK-së për institutin e pranimit të fajësisë, i njëjti është bërë në mënyrë vullnetare dhe mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, dhe është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, andaj nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, gjykatës i ka propozuar që pranimin e fajësisë ta aprovojë.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar ne shqyrtimin gjyqësor lidhur me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka deklaruar se në bazë të konsultimit me të dëmtuarin të cilin e përfaqësojë, vije në përfundim se me vetë faktin e deklarimit personal të të pandehurit, i cili e pranojë fajësinë në tërësi, e që mbështetet në dokumentet relevante të institucioneve gjegjëse të sigurisë si dhe aktakuzën e ngritur nga ana e Prokurorisë Themelore ne Mitrovicë , mbi aktin gjegjesisht veprën të cilën e ka kryer, ne e pranojmë, duke na u mundësuar që në fjalën përfundimtare ti paraqesim kërkesat dhe propozimin që ti ipet verdikti i kësaj çështje penale.

I dëmtuari ka deklaruar se pajtohet me fjalën e përfaqësuesit te tij.

Mbrojtësi i te pandehurit ne fjalën e tije lidhur me pranimin e fajësisë se te pandehurit ka deklaruar se i mbrojturi e pranojë fajësinë këtu në gjykatë dhe se mbrojtja i bashkëngjitet këtij

pranimi vullnetar, edhe pas konsultimeve të mjaftueshme me te si mbrojtës, dhe pas këshillave të nevojshëm në lidhje me benefitet ligjore të pranimit të fajësisë.

Gjykata pranimin e fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar në kuptim të dispozitave të nenit 322 e 242 par 1 të KPP-së dhe ka konstatuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës si dhe ka pranuar deklarimin mbi pranimin e fajësisë nga i pandehuri sepse ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndes dhe atë, procesverballi i marrjes në pyetje të te pandehurit në prokurori dt. 03.05.2024; fleteleshimi nga spitali për te dëmtuarin dt. 07.05.2024; raporti mjekësor i dt. 10.05.2024; raporti i qendrës emergjente në Vushtrri dt. 26.04.2024, në emër të te dëmtuarit; deklarata e te dëmtuarit dhënë në polici dt. 26.04.2024; deklarata e te pandehurit dhënë në polici dt. 26.04.2024; deklarata e dëshmitarit S.H. dt. 26.04.2024; deklarata e dëshmitarit A.M. dt. 26.04.2024; fotodokumentacioni në 6 shtojca; Shënimi zyrtar i hetuesit dt. 26.04.2024; Raporti i Oficerit i dt. 26.04.2024, si dhe shkresat e tjera të lëndes.

Të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale, e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që e ka kryer i pandehuri, andaj mbi këtë bazë gjykata ka vlerësuar këto prova dhe deklaratimet mbi pranimin e fajësisë i ka vlerësuar dhe pranuar.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shteti ka deklaruar se pas aprovimit të pranimit të fajësisë nga ana e gjykatës, në tërësi është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuze, se i akuzuari A.A. me datë, kohë dhe vend si në përshkrim të kësaj aktakuze ka kryer veprën penale *Lëndimi i rëndë trupor* nga neni 186 par. 3 nën par.3.1 lidhur me par. 1 nën par. 1.2 të KPRK-së, andaj prokurori i shtetit gjykatës i ka propozuar që të akuzuarin ta shpallë fajtorë dhe ta dënojë sipas ligjit, ashtu që gjatë matjes së dënimit, llojit dhe lartësisë së tij të merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese.

Si rrethanë lehtësuese prokurori ka veçuar pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor, ndërsa si rrethana rënduese gjykatës i ka propozuar që të merr parasysh shkallën e lartë të dashjes në drejtim të kryerjes së veprës penale, vendosmërinë e tij në kryerjen e kësaj vepre penale, duke marrë parasysh faktin se i njëjti e ka pritur të dëmtuarin dhe e ka goditur më shumë se një herë me anë të një mjete të fortë po ashtu të merr parasysh faktin se edhe pse i dëmtuari kishte rënë në tokë pa vetëdije prapë kishte vazhduar duke e goditur të njëjtin, po ashtu prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që sipas detyrës zyrtare të pajiset me certifikatë nga evidenca penale dhe nëse nga ajo rezulton se i pandehuri është i dënuar edhe më parë ta merr si rrethanë rënduese dhe kundërta nëse nuk është dënuar më parë, ta merr parasysh se rrethanë lehtësuese. Po ashtu prokurori i shtetit i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta obligojë ti paguajë shpenzimet e procedurës penale si dha ta obligojë që të paguajë taksën për kompensimin e viktimave të krimit.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me vetë faktin, pas një veprimi të cilit e konfirmojë edhe gjykata se e pranon fajësinë e të pandehurit, i cili me dashje ka kryer veprën penale *Lëndimi i rëndë trupor*, sipas KPRK-së, neni 186 par. 3 e që përputhet në tërësi me dokumentacionin relevant të institucioneve si dhe deklaratimeve të dëshmitarëve, i cili i pandehur në ditën e caktuar kritike pra me datë 26.04.2024, sulmon të dëmtuarin në një

vend të shenjtë, ku kryhen ritualet fetare me dëshirë për mirësi urtësi dhe harmoni, shkakton dhimbje, lëndime, fraktura, me të cilën përkufizohet termi Lëndimi i rëndë trupor, e tërë kjo konfirmohet me dokumentacionin mjekësor i cili nga prindi edhe familja është përcjellur rregullisht në institucione mjekësore për shërim dhe trajtim duke ardhur në një përfundim, pas intervenimeve operacionale, vije deri te një stabilitet i ndërtimit anatomik të të dëmtuarit, prandaj edhe pse e mbështetëm dhe jemi mbrapa saj se e pranon fajësinë në mënyrë vullnetare, gjykatës i propozojmë përpos shqiptimit të dënimit dhe dhënies së verdiktit për këtë vepër penale të marr parasysh dhe në aktgjykimin të cilin do ta shpallë në dispozitiv të parasheh shpenzimet e shërimit. Vlerësimi i këtij dëmi dhe mundit që ka përjetuar i mbetet gjykatës krahas dokumentacionit relevant të marri një vendim, njëherit gjykatës i dorëzojë pjesët tjera të provave dhe një element i cili len përshtypje për të ardhmen edhe pse ekziston vullneti që të mos zgjerohen problemet, si provë do të dorëzojë se në kontinuitet po vijnë shënime qe i dëmtuari të këtë kujdes dhe ta lëshojë Kosovën. Gjykata le të marr verdiketin sa i përket kësaj çështje penale.

I dëmtuari ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë fjalën e përfaqësuesit, dhe ka shtuar se nuk kanë pranuar kërkim falje nga i akuzuari as sipas traditave, dhe se i është rrezikuar karriera ushtarake pasi i njëjti është ushtar i FSK-së dhe lëndimet e marra, ka shqetësime se lëndimet mund të jenë me pasoja afatgjate dhe mund të shkaktojnë pensionim të parakohshëm. Sa i përket kërkim faljes të të pandehurit mund ta pranojë pasi që të marr kompensimin e dëmit, për gjithë dëmin që më është shkaktuar dhe pasi që i pandehuri të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit ne fjalën e tij përfundimtare fillimisht ka theksuar se në emër të familjes së të pandehurit kërkon falje të dëmtuarit dhe familjes së tij, duke njoftuar gjykatën se para se të fillojë kjo seance kanë pasur një konsultim të shkurtër me përfaqësuesin e palës së dëmtuar duke pretenduar se vullnet dhe dëshirë që pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës palët të arrijnë një pajtim sepse është interes i përbashkët që kjo çështje të mbyllet me pasoja sa më të vogla dhe se këtë mesazh të palës së kundërt e ka kuptuar drejtë dhe e përkrah në tërësi këtë vullnet të shprehur.

Tutje mbrojtësi i te pandehurit ka theksuar se sa i përket çështjes penale i mbrojturi pas konsultimeve të detajuara dhe të mirëfillta me mbrojtësin dhe pasi që atij i janë shpjeguar në detaje benefitet ligjore të cilat ligji dhe gjykata mund të ia njuh në rast të pranimit të fajësisë, i njëjti edhe e pranojë publikisht fajësinë këtu, me çka i kontribuojë esencialisht zhvillimit të pa penguar dhe në mënyrë efikase të kësaj procedure penale, me shpenzime minimale të procedurës dhe me humbje minimale të kohës së çmuar të të gjitha palëve në këtë procedurë. Gjykatës i ka përkujtuar se pranimi i fajit është i paraparë si kusht apo rrethanë e veçante lehtësuese me rastin e marrjes së një vendimi në lidhje me sanksionin penal, ku kjo është paraparë në dispozitën e nenit 69 par 3, pika 6 të KPRK-së, gjithashtu e njëjta është paraparë edhe në dispozitën e nenit 70 par. 3 pika 10 të KPRK-së ku është theksuar decidivisht se është rrethanë veçanërisht lehtësuese pranimi i fajit, te neni 71 par. 1 pika 3 i KPRK-së gjithashtu është theksuar e njëjta kërkesë, në rastet kur kryesi e pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje eventuale për pranimit të fajësisë. Tutje mbrojtësi ka theksuar edhe disa aspekte tjera në favor të pranimit të fajësisë, duke tërhequr vëmendjen se i mbrojturi çfarë të kaluare penale ka, ose më thjeshtë a njihet si kryes i ndonjë vepre penale më herët apo çoftë edhe ndonjë kundërvajtje si kundërvajtjet në

trafik, duke konkluduar se ka informacionin e saktë lidhur me këtë dhe se i mbrojturi nuk ka të kaluar kriminale, kusht ky i rëndësishëm i cili për neve dhe gjykatën paraqet një determinues në lidhje me sanksion penal për të gjithë ata persona të cilët për herë të parë bien në konflikt me ligjin, i mbrojturi im nuk është i njohur si përsëritës, ka ndodh çka ka ndodh dhe ne shprehim keqardhje dhe kërkojmë falje, të cilën i mbrojturi i shprehi publikisht këtu për të dëmtuarin dhe familjen e tij. Vetë fakti i shprehjes së kërkim faljes tregon se i njëjti është penduar thellë për rastin që ka ndodh, i njëjti gjithashtu i premtonte gjykatës publikisht se në të ardhmen nuk do të ndërmerre asnjë lloj veprimi i cili bie ndesh me ligjin. Pa dashur mbrojtja që ta justifikojë veprimin e tij, dhe pa hyrë në detaje të rastit se si ka ndodh, rasti nuk ka treguar në fakt një intensitet të lartë të dashjes sepse nuk ka pasur elemente përgatitore, sepse i tërë rasti ka ndodhur nga një rrethanë e çastit e momentit, rrethanë banale rreth thirrjes së ezanit apo faktit se kush është ai i cili duhet ta thërrasë ezanin, meqë hoxha i fshatit atë ditë ose nuk ishte prezent apo nuk ishte i disponuar nga ndonjë pengesë tjetër që ta thërrasë ezanin, kjo ishte e pa kalkuluar ishte momenti pa dashur ta fajësojmë njërin apo tjetrin palë. Tutje ka theksuar se të dy palët janë kontribuues për këtë çështje, duke tërhequr vëmendjen se i pandehuri e ka pranuar fajësinë siç është përshkruan në aktakuzë. Mbrojtësi tutje ka cituar edhe dispozitën e nenit 72 të KPRK-së, par. 1 pikën 5 ku janë theksuar kufijtë e zbutjes së dënimeve në rast se plotësohen në mënyrë kumulative shumica prej rrethanave lehtësuese dhe pika 5 thotë se “nëse për veprë penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një viti, dënimi mund të zbutet deri në 3 muaj burgim”, duke theksuar se kjo i mbetet gjykatës që ti vlerësojë të gjitha rrethanat dhe pretendimet e mbrojtjes dhe të zbatojë dispozitat ligjore, duke kërkuar që i mbrojturi të dënohet në kundër të ligjit, dhe duke konkluduar se përfundimisht dëshirat e palëve për tu pajtuar pas gjykimit janë të drejta dhe legjitime dhe se bashkëngjitet atë sa palët lejojnë që të kontribuojnë në atë drejtim, në interes të dy palëve, pa ia mohuar palës tjetër kërkesën për kompensimin e dëmit, që do të zhvillohen në një procedurë tjetër duke propozuar një sanksion penale të arsyeshëm në kuptim të nenit 38 të KPRK-së, gjykatës i ka propozuar që ndaj të pandehurit të shqiptojë një sanksion sa më të lehtë penale dhe palës tjetër të ia japë të drejtën që në procedurë tjetër të realizojnë kërkesat e saj legjitime, duke aluduar ne kërkesën pasurore.

I pandehuri ne fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbështetë fjalën e mbrojtësit dhe kërkon falje, i premtoj gjykatës se nuk ka me ndodh më ky rast e asnjë rast tjetër.

Me lejen e gjykatës i dëmtuari ka kërkuar fjalën dhe ka deklaruar se sa i përket kërkim faljes se te pandehurit, si i dëmtuar e merr me rezervë kërkim faljen për arsye se ka qenë dëshmitarë në rastin e datës 24.05.2023 ku një i afërm i te dëmtuarit është therrë me thikë 8 herë nga një i afërm i të pandehurit, arsyeja tjetër pse ishte i rezervuar në kërkim faljen e të pandehurit është sepse të njëjtit janë pajtuar me të afërmin e te dëmtuarit i cili ka qenë i dëmtuar në rastin paraprak, i therrurr më thikë, dhe pas kërkim faljes, të njëjtit persona e kanë sulmuar të dëmtuarin, pasi që janë pajtuar. Ai si i dëmtuar i hedhi poshtë pretendimet e mbrojtësit të të pandehurit që u mundua me më bo te dëmtuarin si të përfshirë aty (duke aluduar ne ngjarjen ku kishte pësuar lëndime), dhe ai kishte shkua me të vetmin qëllim për arsye religjioze sepse falet qe 10 vite, ndërsa nuk ka shkua me mjete të forta si i pandehuri, me shkop, duke konkluduar sipas bindjes se te dëmtuarit se i pandehuri kishte shkua ne xhami me të vetmin qëllim sepse ka dëgjuar se i dëmtuari do ta

thërrasë ezanin dhe në atë moment ka arritur, ku sipas bindjes se te dëmtuarit krejt kjo ka qenë e planifikuar.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese si: pranimin e fajësisë, dhe shprehjen e keqardhjes për veprën e kryer.

Gjykata ne vështrim te dispozitave te nenit 69 e 70 te KPRK-së ka marrë parasysh por pa u kufizuar ne rrethanat renduese ne vijim ku si rrethanë renduese konsideroj, motivet për kryerjen e veprës penale ku si motiv është spikatur motivi i hakmarrjes, rrethanat ne te cilat është kryer vepra penale pasi qe vepra penale është kryer te objekti i kultit fetar, sjelljen e kryesit pas kryerjes se veprës penale ku kryesi edhe pas kryerjes se veprës penale e ka paralajmëruar te dëmtuarin qe “ta lëshoj Kosovën”, shkallen e lartë te dashjes se te pandehurit ku i pandehuri edhe pasi ishte rrezuar i dëmtuari, kishte vazhduar ta godas, prezencën e dhunës dhe kanosjes me dhunë edhe pas kryerjes se veprës penale, si dhe rrethane renduese morri edhe moshën e re te te dëmtuarit.

Në nenin 186, par.1, të KPRK-së është parashikuar se formën themelore të veprës penale Lëndim i rëndë trupor e kryen “Kushdo që i shkakton lëndim të rëndë trupor personit tjetër ose e dëmton shëndetin e personit tjetër deri në masën e tillë sa që mund të rezultojë me: 1.1. dobësimin e përkohshëm ose esencial të një pjese vitale të trupit të personit tjetër; 1.2. paaftësimin e përkohshëm, zvogëlimin e përkohshëm dhe esencial ose zvogëlimin e përhershëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; ose 1.3. dëmtimin e përkohshëm dhe serioz të shëndetit të personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet. Kurse si formë e kualifikuar e kësaj vepre penale është dispozita e nenit 186 par 3 nenpar 3.1 ku qëndron se “Kur vepra penale nga paragrafi 1 ose 2 i këtij neni është kryer me armë, mjet të rrezikshëm apo me ndonjë send tjetër që mund të shkaktojë lëndim të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit, kryesi dënohet me: 3.1.burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni” e qe ne rastin konkret ne veprimet e te pandehurit është kryer pikërisht kjo formë e kualifikuar e veprës penale.

Gjykata duke pasur parasysh të gjitha rrethanat (rënduese dhe lehtësuese) të cekura më lartë, ka vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për aplikim të dispozitave për zbutjen e dënimit nga 71 i cili parasheh “Gjykata mund të shqiptojë dënim nën kufirin e paraparë me ligj apo të shqiptojë lloj më të butë të dënimit: 1.1. kur ligji parasheh që dënimi i kryesit mund të zbutet apo të zvogëlohet; 1.2. kur gjykata konstaton se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe me shqiptimin e dënimit më të butë; ose 1.3. në rastet kur kryesi pranon fajësinë ose ka arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë.” dhe 72 par.1, pika 1.5 në të cilin edhe parasheh “Kur ekzistojnë kushtet për zbutjen e dënimit nga neni 71 i këtij Kodi, gjykata mund të zbusë dënimin brenda kufijve në vijim: nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej një (1) viti, dënimi mund të zbutet deri në tre (3) muaj burgim.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar me burgim efektiv si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi është i drejtë dhe i ligjshëm, në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale dhe intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur dhe se nuk ka pasur vend qe te shqiptoj dënim me te ashpër apo me te butë. Gjykata vlerëson se dënimi me burgim ne rastin konkret është i domosdoshëm

në mënyre që të arrihet qëllimi i dënimit si në dispozitat e nenit 38 të KPRK-së dhe atë që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale, dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Së këndejmi me pranimin e gjitha këtyre rrethanave, nuk ka pasur vend që të pandehurit t'i shqiptohen dënim më të rëndë apo më të bute. Andaj, gjykata vlerësojë se edhe me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 të KPP-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil gjykata e ka bazuar në nenin 462 të KPPK.

Nga të lartë cekurat e bazuara në nenin 364 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.107/24, datë: 21.08.2024

Zyrtarja Ligjore
Arta Jusufi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi. Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.